

PRIORITETET DHE QËLLIMET PËR VITIN 2023

Prioritetet dhe synimet prioritare të Entit për vitin 2023 janë

1. Rritja e efikasitetit në zbatimin e procedurës administrative për njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale;
2. Krijimi i një sistemi mbrojtjeje të përshtatshme me standardet evropiane dhe botërore;
3. Forcimi i bashkëpunimit me Zyrat e pronësisë industriale dhe intelektuale të vendeve të tjera dhe në këtë kuadër nënshkrimi i marrëveshjes për bashkëpunim dypalësh me Zyrën e Greqisë;
4. Forcimi i bashkëpunimit në fushën e pronësisë industriale me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe Organizatën Evropiane të Patentave;
5. Forcimi i bashkëpunimit në fushën e patentave me Zyrën Evropiane të Patentave;
6. Forcimi i bashkëpunimit me Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian;
7. Integrimi në sistemet rajonale dhe ndërkombëtare të mbrojtjes;
8. Forcimi i sistemit të mbrojtjes së pronësisë industriale;
9. Ngritja dhe forcimi i mëtejshëm i nivelit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të përfshira në mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;
10. Inkurajimi i përdorimit të pronësisë industriale si bazë për zhvillimin ekonomik;
11. Zhvillimi i Entit Shtetëror të Pronësisë Industriale në një institucion të orientuar drejt shërbimeve;
12. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Zyrës Shtetërore për Pronësi Industriale dhe sektorit joqeveritar.